

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7884
E martë, 17 shtator 2024
Çmimi 0.50 €

Evropa përballet me vërshime vdekjeprurëse | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



KONJUFCA: NUK U FRIKËSOHEMI KËRCËNIMEVE TË VUÇIQIT. | FAQE 4-5



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka folur të hënën për situatën në veri, procesin e dialogut, kërcënimet e presidentit serb Aleksandër Vuçiq dhe për

aktakuzën në rastin e Banjskës. Konjufca ka thënë se po të ishte në pushtet klasa e vjetër politike, veriu i Kosovës do të përfundonte në negociata. Ndërkaq ka thënë

se nuk i bëjnë përshtypje kërcënimet e Vuçiqit. Sa i përket dialogut, kryeparlamentari Konjufca ka ripërsëritur se ky proces tashmë ka vdekur

KOSOVA KËRKON NGA HUNGARIA TA NDIHMOJË PËR ANËTARËSIMIN NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE | F. 3



Reagim i KMDLNj-së



DITA NDËRKOMBËTARE E DEMOKRACISË DHE GJYKATA SPECIALE | F. 7

REKRUTIMI PËR POZITA TË LARTA, "CORRWATCH" KRITIKON MINISTRINË E FINANCEVE DHE ATË TË TREGTISË | F. 8

INFLACIONI NDIKON NË RITJEN E KOSTOS SË NDËRTIMIT NË KOSOVË | F. 8

SPORT | F. 10



SPORTI, MJET THELBËSOR PËR ZHVILLIMIN E DEMOKRACISË | F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni Xhepçisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Evropa përballet me vërshime vdekjeprurëse

BUKURESHT, 16 SHTATOR - Disa shtete evropiane po përballet me vërshime vdekjeprurëse. Rumania ka raportuar për gjashtë të vdekur nga vërshimet, teksa në Poloni ka vdekur një person, sikurse në Austri. Edhe Republika Çeke po përballet me vërshime. Në këtë shtet janë raportuar disa të zhdukur. Mijëra persona në Evropën Qendrore janë evakuuar si pasojë e reshjeve të shiut, teksa parashikimet janë që këto do të përballet edhe me më shumë reshje shiu.

Rreth 250 000 familje vazhdojnë të mbeten pa energji elektrike, ndërsa në kryeqytetin Pragë autoritetet ndërmorën masa për t'i parandaluar përmbytjet rreth lumit Vltava.

Kryeministri çek Petr Fiala tha se përmbytjet e tilla "ndodhin një herë në shekull". Shirat e furishëm nisën qysh në fund të



javës së kaluar dhe pritet të vazhdojnë edhe gjatë ditës së hënë.

Kryeministri i Hungarisë, Viktor Orban, tha se i ka anuluar të gjitha "detyrimet e tij ndërkombëtare", pasi vendi i

tij pritet të përfshihet nga përmbytje të mëdha.

Orban, i cili pritej të fliste këtë javë në Parlamentin Evropian, tha përmes një postimi në rrjetet sociale se "për shkak të kushteve ekstreme të motit dhe



përmbytjeve të vazhdueshme... kam shtyrë të gjitha detyrimet e mia ndërkombëtare".

Kryebashkiaku i Budapestit, Gergely Karacsony, shkroi në "Facebook" se përmbytjet më të mëdha në një dekadë priten

të arrijnë në këtë qytet gjatë javës.

Ekipet e emergjencës kanë mbushur qindra mijëra thasë me rërë për të ndihmuar në mbrojtjen e qytetit nga rritja e nivelit të ujit në lumin Danub.

Ukraina i fton OKB-në dhe Kryqin e Kuq Ndërkombëtar në Kursk të Rosisë



KIEV, 16 SHTATOR - Ukraina tha të hënë se u ka kërkuar Kombeve të Bashkuara dhe Komisionit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (ICRC) t'u bashkohen përpjekjeve humanitare në rajonin Kursk të Rosisë, në të cilin forcat ukrainase e kryen një inkursion në gusht.

Ushtria ukrainase tani ka në kontroll rreth 100 vendbanime në rajonin e Kurskit një muaj pasi e nisi inkursionin befasues, sipas presidentit të Ukrainës, Volodymyr Zelensky.

Ministria e Mbrojtjes e Rosisë tha se forcat ruse i kanë rimarrë në kontroll edhe dy fshatra të tjera në këtë rajon.

Ministria e Jashtëm e Ukrainës, Andriy Sybiha, tha se e udhëzoi të dielën Ministrinë e vet t'i ftojë OKB-në dhe ICRC-në të punojnë në rajonin e Kurskut. "Ukraina është e gatshme ta lehtësojë punën e tyre dhe të silltë në përputhje me ligjin ndërkombëtar humanitar", tha Sybiha në X gjatë një vizite në Sumi, nga ku forcat ukrainase e nisën sulmin matanë kufirit. Ai tha se ushtria ukrainase po garanton ndihmë humanitare dhe kalim të sigurt për civilët në rajonin e Kurskut.

Ministria e Jashtëm e Ukrainës tha se ftesat u janë dërguar OKB-së dhe ICRC-së "duke marrë

parasysh gjendjen humanitare dhe nevojën për të siguruar të drejta themelore njerëzore në territorin e rajonit të Kurskut". Ajo tha se i ka kërkuar ICRC-së të vëzhgojë nëse Ukraina po vepron në përputhje me parimet e ligjit ndërkombëtar humanitar.

Nuk është e qartë nëse OKB-ja dhe ICRC-ja janë përgjigjur.

Agjencia shtetërore e lajmeve e Rosisë, TASS, e citoi zëdhënësin e Kremlinit, Dmitry Peskov, duke thënë se deklaratat e tilla janë "provokuese". Ai e bëri të qartë se Moskë, e cila e nisi pushtimin e plotë të Ukrainës më 2022, pret që OKB-ja dhe ICRC-ja të mos i pranojnë ftesat.

Gjermania nis kontrollet në të gjithë kufijtë tokësorë

BERLIN, 16 SHTATOR - Gjermania nisi të hënë kontrolle të rastësishme në kufijtë e saj me pesë vende të Evropës Perëndimore, në përpjekje për ta luftuar migrimin e parregullt.

Kontrollet policore filluan në orët e mëngjesit në kufijtë me Francën, Holandën, Belgjikën, Luksemburgun dhe Danimarkën dhe do të vazhdojnë për gjashtë muaj.

Nga viti i kaluar Gjermania zbaton kontrolle të tilla edhe në kufijtë me Poloninë, Republikën Çeke, Austrinë dhe Zvicrën.

Gjermania, anëtare e Bashkimit Evropian, njoftoi qysh javën e

kaluar se do t'i zgjerojë kontrollet kufitare në të nëntë kufijtë e saj tokësorë, si masë për ta goditur migracionin e parregullt dhe krimin, pas sulmeve të fundit ekstremiste.

Muajin e kaluar, nga një sulm me thikë në qytetin Solingen, u vranë tre persona.

Sulmuesi i dyshuar, një azilkërkuar sirian, tha se është frymëzuar nga grupi militant Shteti Islamik.

Në qershor, një sulm tjetër me thikë - për të cilin u fajësua një imigrant afgan - la të vdekur një oficer të policisë, ndërsa katër persona të tjerë u plagosën.

Kontrollet kufitare, sidoqoftë, kanë vënë në sprovë unitetin evropian, sepse disa argumentojnë se ato janë në kundërshtim me zonën e lëvizjes së lirë brenda BE-së, e njohur si Schengen.

Me rregullat e BE-së shtetet anëtare mund të vendosin përkohësisht kontrolle në të ashtuquajturit kufij të brendshëm, në rast të ndonjë kërcënimi serioz, siç është ai për sigurinë kombëtare. Por, me rregulla, kontrollet kufitare duhet të zbatohen si mjeti i fundit në situata të jashtëzakonshme dhe duhet të jenë të kufizuara në kohë.



REAGIM I KMDLNJ-së

Dita Ndërkombëtare e Demokracisë dhe Gjykata Speciale

Organizata e Kombeve të Bashkuara ka caktuar 16 shtatorin si Ditën Ndërkombëtare të Demokracisë e cila, varësisht nga niveli i zhvillimit të demokracisë, perceptimit të saj, nevojave politike, diku festohet, diku shënohet kurse në disa vende edhe injorohet. Realisht, sidomos në vendet ku transicioni zgjatë më shumë, Kosova është e tillë, demokracia më shumë apo kryesisht imponohet nga jashtë, nga shtetet që kanë ndikim të fuqishëm politik dhe ekonomik, prandaj edhe i nënshtrimit inercionit të kushtëzuar nga të fortit e botës e që ambalazhohen si të drejta të njeriut. Edhe në Kosovë kjo ditë shënohet, nuk festohet, me aktivitete simbolike dhe retorikë të stërlodhur të politikanëve kosovarë, të pozitës apo opozitës.

Më 3 gusht 2015, Kuvendi i Kosovës miratoi Nenin 162 të Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjin për Dhomat e Specializuara për të cilin votuan 82 deputetë, 5 ishin kundër dhe 1 absteno.

Po bëhen më tepër se 4 vite që po mbahen në paraburgim presidenti Hashim Thaçi, kryetarët e Kuvendit, Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli dhe kryetari i GP të LVV-së, Rexhep Selimi. Më parë ishin dënuar me dënime drakonike drejtuesit e OVLUÇK-së, Nasim Haradinaj dhe Hysni Gucati, tash të liruar me kusht dhe me gojë të mbyllur, Pjetër Shala pret shqiptimin e dënimit ndërsa të burgosurit tjerë,



ose janë duke u gjykuar apo në pritje të gjykimit. Salih Mustafa, komandant Cali, në kundërshtim me çdo logjikë juridike dhe duke dhunuar brutalisht nga ana e gjykatës të drejtën e zbatimit të ligjit më të favorshëm për të akuzuarin, nga burokratë të kësaj gjykate u dënua me 26 vjet burg. Trupi gjykues iu nënshtrua padenjësisht kryetares së Gjykatës Speciale e cila, në disa intervista deklaronte se të burgosurit e Hagës mund të dënohen me burg të përjetshëm që ishte qëndrim paragjykes dhe ndërhyrje në pavarësinë e gjyqësorit. Krimi

juridik ndaj Salih Mustafës u zbutë paksa me një ulje simbolike të dënimit ndërkaq Gjykata e Apelit, pasi e shqyrtoi rastin erdhi në përfundim se tavani i dënimit, kur të zbatohet ligji më i favorshëm për të dënuarin është 15 vjet. Gjykata Speciale në Hagë deklarohet se është pjesë e sistemit juridik të Kosovës dhe se punon sipas ligjeve të Kosovës që aspak nuk është e vërtetë, është mashtrim ordiner. Kjo Gjykatë nuk e ka asnjë shenjë identifikuese të Kosovës, nuk i përgjigjet me asgjë Kosovës, nuk lejon monitorim të pavarur, është

tmerrësisht jotransparente duke dhunuar parimin e publicitetit përmes seancave të mbyllura, redaktimit jonormal të materialeve, përjashtimit të publikut dhe mospërkthimit me kohë të materialeve për të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre në gjuhën që e kuptojnë e që është e drejtë elementare e njeriut, si njëra ndër vlerat kryesore të demokracisë. Për raste të ngjashme në Kosovë, kur serbët e dyshuar janë dënuar për krime lufte dhe kur nuk është zbatuar ligji më i favorshëm për të dënuarin, reagimi ndërkombëtar

ka qenë i menjëhershëm dhe i rreptë, për rastin e Salih Mustafës nuk pati asnjë reagim hiç këtu reagimeve individuale ndërkaq munguan reagimet institucionale shkak se, ose kishin frikë se do të akuzohen për ndërhyrje në drejtësi ose, në anën tjetër pozita aktuale dhe një pjesë e opozitës ishin të kënaqura me këtë dënim për faktin se kishin dhënë kontribut konkret për këtë. Për KMDLNJ-në është i papranueshëm fakti që deputetët e Kuvendit të Kosovës, nuk guxuan apo nuk deshën që në një seancë apo edhe në disa seanca të diskutohet për shkeljet flagrante të drejtave të njeriut që i bëhen të burgosurve në Hagë, të gjithë shqiptarë dhe të gjithë shtetas të Kosovës, themelues dhe bartës të luftës së UÇK-së, shpallës së pavarësisë së Kosovës, ndërtues të shtetit dhe të paqes që çnjerëzisht po trajtohen nga kjo Gjykatë dhe vet shteti i Kosovës, në kundërshtim me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut e OKB-së, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Kushtetutën e Kosovës dhe, specifikisht në kundërshtim me Konventën kundër Trajtimin Degradues dhe Çnjerëzorë.

Prandaj është hipokrizi profesionale dhe morale që të flitet për Ditën Ndërkombëtare të Demokracisë kur kemi dhunim praktik dhe brutal të demokracisë ndaj të burgosurve që po mbahen peng në Qendrën e Paraburgimit në Hagë.

Gjashtë dizajnerë të rinj nga Ballkani Perëndimor krijojnë logon e re të përhershme për Samitin e Berlinit

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Samiti i Procesit të Berlinit ka një identitet të ri vizual falë një ekipi të talentuar prej gjashtë dizajnerëve të rinj nga Ballkani Perëndimor. Ata janë përzgjedhur përmes një thirrjeje publike nga Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO), në partneritet me Ministrinë e Jashtme Federale të Gjermanisë në qershor të këtij viti.

Dizajnerët kanë punuar së bashku për të krijuar një logo që do të shërbejë si simbol i përhershëm vizual për këtë ngjarje prestigjioze, e cila mbledh çdo vit udhëheqës nga Ballkani Perëndimor, Bashkimi Evropian dhe institucionet e BE-së. Ekipi që qëndron pas logos së re përbëhet nga Alkid Shuli nga Shqipëria, Rreze Guri nga Kosova, Amila Redžić nga Bosnjë-Hercegovina, Lana Klenak nga Mali i Zi, Bojan Budjarovski nga Maqedonia e Veriut dhe Milana Ružić nga Serbia, mentoruar nga



drejtori kreativ Fisnik Ismaili. Publiku do ta ketë mundësinë të shohë logon e re në Samitin e

Procesit të Berlinit, i cili do të mbahet në Berlin këtë tetor, si dhe në ngjarje të tjera të Procesit

të Berlinit, përfshirë takimet ministeriale, forumet rinore të RYCO-së dhe aktivitete të tjera në

kuadër të kësaj platforme bashkëpunimi ndërmjet Ballkanit Perëndimor dhe BE-së. Kjo iniciativë për një logo të përhershme është pjesë e festimeve për shënimin e 10-vjetorit të Procesit të Berlinit, i cili u krijua në vitin 2014 për ta promovuar bashkëpunimin dhe mbështetjen për rrugën e Ballkanit Perëndimor drejt integrimit në BE. Në vitet e fundit Procesi i Berlinit ka evoluar duke përfshirë Samitin si ngjarjen kryesore, përveç takimeve ministriore, forumeve dhe aktiviteteve të tjera.

Që nga viti 2021 RYCO ka organizuar konkurse publike vjetore për zgjedhjen e logos së Samitit, me fitues individualë të njohur për dizajnet e tyre vizuale. Përpjekja e ekipit të këtij viti për të krijuar një identitet vizual të përhershëm ka qenë vlerë e shtuar dhe ka forcuar bashkëpunimin rajonal në Ballkanin Perëndimor.

Konjufca: Nuk u frikësohemi kërcënimeve të Vuçiqit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka folur të hënën për situatën në veri, procesin e dialogut, kërcënimet e presidentit serb Aleksandër Vuçiq dhe për aktakuzën në rastin e Banjskës. Konjufca ka thënë se po të ishte në pushtet klasa e vjetër politike, veriu i Kosovës do të përfundonte në negociata. Ndërkaq ka thënë se nuk i bëjnë përshtypje kërcënimet e Vuçiqit. Sa i përket dialogut, kryeparlamentari Konjufca ka ripërsëritur se ky proces tashmë ka vdekur

PRISHTINË, 16 SHTATOR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka folur për situatën në veri, procesin e dialogut, kërcënimet e presidentit serb Aleksandër Vuçiq dhe aktakuzën në rastin e Banjskës. Konjufca ka thënë se po të ishte në pushtet klasa e vjetër politike, veriu i Kosovës do të përfundonte në negociata. “Ju kujtohet, ishte një bojkotim i orkestruar prej anës së institucioneve, policëve që dhanë dorëheqje, kryetarëve të komunave dhe Kosova ishte para dy opsioneve. Unë jam i sigurt se po të kishte qenë opsioni i vjetër politik në Kosovë do të kishim përfunduar në negociata, por ky nuk ka qenë opsioni ynë. Opsioni ynë është kushtetutshmëria me çdo kusht. Kosova do të përfundonte shumë keq nëse pas dhunës, kushtëzimeve dhe imponimeve, veriu i Kosovës do të përfundonte në negociata. Ky nuk

ka qenë opsion për LV-në dhe qeverisjen e saj”, ka thënë Konjufca të hënën. Ai ka folur edhe për deklaratat e fundit të presidentit serb Aleksandër Vuçiq. Konjufca ka thënë se nuk i bëjnë përshtypje kërcënimet e tilla. “Vuçiqi po tenton t’i ruajë ato që nuk i ka më dhe po kërcënon Kosovën përmes konferencave për shtyp. Është kërcënim që neve nuk na bënë përshtypje. Ne nuk frikësohemi e shqetësohemi, sepse në atë pjesë janë institucionet e Kosovës, ato të sigurisë”, ka thënë Konjufca. Ai ka shtuar se substanca e strukturave paralele tashmë është hequr nga Kosova. Sa i përket dialogut, Konjufca ripërsëriti se ky proces tashmë ka vdekur. “Unë kam thënë se me këtë strukturë dialogu tashmë ka vdekur. Të shohim çfarë po ndodh në vitin 2025”, ka thënë ai. Lidhur me ngritjen e aktakuzës



ndaj 45 personave për rastin e sulmit terrorist në Banjskë, Konjufca u shpreh se “nga kuptimi politik do të thosha që është një aktakuzë e cila mendoj që për nga definicioni i çështjeve që ka

ngritur, ka goditur në shenjë. Synimi i grupit terrorist ka qenë aneksimi i një pjese të Kosovës. Me këtë pretendim ka pasur njerëz që kanë bërë shaka, por kjo nuk është shaka, por e vërtetë. E

dyta, grupi terrorist e ka pasur mbështetjen e Serbisë. Dhe e treta dhe e katërta, kanë qenë tentimi për ta shkatërruar rendin kushtetues dhe sigurinë nacionale të Kosovës”.

Shënohet Dita e Demokracisë, qeveria kritikohet për cenim të vlerave demokratike

Prishtinë, 16 shtator - Kuvendi i Kosovës ka shënuar Ditën Ndërkombëtare të Demokracisë me moton “Qeverisja efektive e inteligjencës artificiale në të gjitha nivelet”. Kryeparlamentari Glauk Konjufca ka thënë se kjo ditë është thirrje për vëmendje nga institucionet për ndërtimin e politikave dhe kapaciteteve njerëzore. Ai ka theksuar se shënimi i kësaj dite është një mundësi për ta theksuar rëndësinë e idealeve të lirisë, barazisë dhe drejtësisë. “Në një kohë kur në mbarë botën gjithnjë e më shumë fatkeqësisht po merr hapësirë keqinformimi dhe dezinformimi, tema globale për Ditën Ndërkombëtare të Demokracisë këtë vit nga Kombet e Bashkuara është caktuar inteligjenca artificiale si një mjet për qeverisje më të mirë krahas reziqeve që paraqiten për demokracinë, atëherë kur nuk kemi mekanizma kontrollues. Kjo është, ndër të tjera, një thirrje për



vëmendje nga institucionet tona që të punojmë bashkërisht për ndërtimin e politikave dhe kapaciteteve njerëzore për ta vënë në funksion inteligjencën artificiale, me synim që të rritet efikasiteti, transparenca dhe vendimmarrja për të krijuar qeverisje të përgjithshme, duke e ruajtur edhe besimin dhe integritetin në proceset e qeverisjes demokratike”, ka thënë Konjufca. Ai ka shtuar se demokracia

mirëmbahet nëpërmjet angazhimit qytetar, teksa ka theksuar se zgjedhjet janë qenësore për demokracinë. Drejtoresha e Institutit Nacional Demokratik (NDI) në Kosovë, Nancy Soderberg, ka folur për inteligjencën artificiale, për çka tha se edhe në Kosovë ka pasur raste të ndikimit të gratë. “Inteligjenca artificiale ofron mundësi të mëdha për progres, por kjo teknologji e mrekullueshme

paraqet edhe sfida themelore posaçërisht se si përballet me të drejtat e njeriut dhe vlerat demokratike. Në Kosovë kemi parë se AI dhe mjetet digjitale mund të keqpërdoren për ta prishur pjesëmarrjen e grave, pastaj duke përhapur narrativë të rrezikshme dhe duke minuar vlerat demokratike. Kosova ka mundësi për të ndërtuar standarde të larta që të shfrytëzohen në të mirë të shoqërisë në përgjithësi dhe duke promovuar transparencën”, shtoi ajo. Kryetarja e Forumit për Transparencë Parlamentare, Arbëresha Kryeziu-Hyseni, ka theksuar se Kuvendi është vendi më demokratik, dhe shtoi se janë rritur transparenca dhe llogaridhënia. “Kuvendi sot është më i hapur e më i qasshëm se asnjëherë më parë dhe për këtë arsye është rritur transparenca dhe llogaridhënia është më e madhe”, ka thënë ajo. Ndërkaq deputetja e Partisë

Demokratike të Kosovës, Blerta Deliu-Kodra, ka thënë se janë cenuar vlerat demokratike. “Duhet të flasim për gjendjen e rëndë dhe jo rrallë cenimin që u është bërë vlerave demokratike të Kosovës. Kur jemi këtu, pa dyshim që duhet të flasim edhe për cenimin jo të rrallë që këto vlera demokratike e kanë pasur gjatë këtyre viteve. Kemi pasur një qeveri jodemokratike e cila jo rrallë ka cenuar fondamentin e shtetit. Mungesa e llogaridhënies, e cila u përmend tash, ka qenë jo rrallë në thelb të diskutimeve tona në Kuvend. Ministrat kanë qenë të papërgjegjshëm. Nëse i shohim raportet e organizatave të shoqërisë civile, kemi një kryeministër i cili në sesionin pranveror 36 herë nuk u është përgjigjur kërkesave dhe pyetjeve parlamentare të deputetëve”, ka përfunduar ajo. Në hollin e Kuvendit të Kosovës është organizuar edhe panairi i organizatave të shoqërisë civile.



Bregu: Besimi te bashkëpunimi rajonal vazhdon të rritet, shënohet rekord prej 82 % këtë vit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

TIRANË, 16 SHTATOR - Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC) ka paraqitur në Tiranë edicionin e 10 të Ballkan Barometrit, sondazhi më i madh i opinionit publik dhe i biznesit në rajon.

Aktiviteti u hap nga sekretarja e përgjithshme e RCC-së, Majlinda Bregu dhe shefi i delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, Silvio Gonzato, pasuar nga prezantimi i gjetjeve të Barometrit të Ballkanit, përmes një diskutimi të hapur në mes të Bregut dhe audiencës së përbërë nga të rinj, përfaqësues të organizatave rinore rajonale. "Barometri i Ballkanit zbulon se rritja e çmimeve dhe inflacioni janë shqetësimi më i madh këtë vit për njerëzit e Ballkanit Perëndimor, të cilët gjatë dekadës së fundit shqetësoheshin më shumë për situatën ekonomike dhe papunësinë. Ky ndryshim

nuk vjen si befasi, pasur parasysh se inflacioni në Ballkanin Perëndimor është gati dyfishi i atij të BE-së (respektivisht 8,1 % e 3,4 %), ndërsa çmimet e ushqimeve janë pothuajse të njëjta si në BE. Megjithatë, BPV-ja jonë është vetëm gjysma e asaj të BE-së", tha sekretarja e përgjithshme e RCC-së, Majlinda Bregu, ndërsa paraqiti të dhënat e dala nga sondazhi. "Gjërat po ndryshojnë, jo vetëm rrethanat rreth nesh, por edhe perspektivat tona. Mbështetja për anëtarësimin në BE, nisur me 39 % në 2015, arriti kulmin me 62 % më 2021 dhe prej atij momenti nisi rënia. Sot ajo qëndron në 54 % - më e ulëta në gjashtë vitet e fundit. Lohja nga zvarritja e zgjerimit, ndonëse më pak, është reflektuar edhe në qarqet e biznesit. Ndërsa mbështetja për anëtarësimin në BE midis liderëve të biznesit ka zbritur 7 % gjatë vitit të kaluar, me 64 % ende në favor ajo vazhdon të mbetet më e lartë se në mesin e

publikut të gjerë. Pavarësisht kësaj, shumë qytetarë mbeten me shpresë. Dyzetë e tre për qind besojnë se anëtarësimi në BE do të ndodhë deri në vitin 2035, kurse një e katërta mendon se do të marrë më shumë kohë. Në mënyrë inkurajuese, më pak njerëz se vitin e kaluar, 18 % besojnë se ekonomia e tyre nuk do të anëtarësohet kurrë në BE, një rënie prej 10-pikësh prej vitit 2022", shtoi Bregu.

Ky sondazh vjetor është kryer me gjashtë mijë njerëz dhe 1 200 biznese nga i gjithë Ballkani Perëndimor, duke dhënë një pasqyrë të opinionëve të tyre mbi bashkëpunimin rajonal, integrimin në BE, besimin tek institucionet publike dhe mediet, shqetësimet e tyre më të mëdha, punësimin, ndryshimet klimatike, sigurinë, jetën digjitale, transportin, sundimin e ligjit, udhëtimin etj. Që prej fillimit më 2015, anketa ka biseduar me mbi 65 000 qytetarë dhe rreth 13 500

biznese duke pasqyruar opinionet e tyre. "Në një notë pozitive, besimi te bashkëpunimi rajonal është në rritje. Këtë vit një rekord prej 82 % e qytetarëve shprehën mbështetjen e tyre për të - rezultati më i lartë që nga fillimi i Barometrit të Ballkanit më 2015. Kjo thekson se bashkëpunimi rajonal ka vlerë të vetën, në vend se të vështrohet në kontekstin e integritimit evropian siç ka ndodhur në vitet e kaluara. Megjithatë, politika nacionaliste vazhdon të shihet si pengesë e madhe për bashkëpunimin rajonal. Ndërsa besimi dhe optimizmi në rajon mbeten të kujdesshëm, ka shenja përmirësimi në mënyrën se si njerëzit perceptojnë këto çështje, pasi opinioni publik evoluon aq shpejt sa guximi politik lejon", ka thënë Bregu.

Disa nga gjetjet kryesore të Barometrit të Ballkanit. Sentimenti publik është përmirësuar: nga 35 % në vitin 2015, në 49 % tani. Në vitin 2020,

26 % e qytetarëve të rajonit ishin të mendimit se Ballkani Perëndimor u jepte shpresë, por tani kjo vlen vetëm për 12 %. Në vitin 2024 ndjenja dominuese është "Konflikti" me 22 %. 20 % e qytetarëve të Ballkanit Perëndimor shpresojnë për anëtarësim në BE deri në vitin 2030, ndërsa 23 % presin që kjo të ndodhë ndërmjet 2030 dhe 2035. Në vitin 2015, 27 % besonin se do të ndodhte deri në vitin 2020 dhe 21 % deri në vitin 2025. Më pak njerëz, 18 %, besojnë se ekonomia e tyre nuk do të anëtarësohet kurrë në BE, një rënie prej 10 pikësh nga viti 2022.

Në vitin 2021, kur pyetëm qytetarët nëse ishin të gatshëm të punonin në Ballkanin Perëndimor, vetëm 7 % u përgjigjën pozitivisht, ndërsa tani në 2024-n, 22 % e tyre janë të gatshëm për këtë. Besimi në institucionet mbetet në nivele të ulëta: partitë politike vazhdojnë të gëzojnë më pak besim me 74 %.

Kuvendi diskuton për përfitimet e inteligjencës artificiale në procesin zgjedhor

PRISHTINË, 16 QERSHOR - Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D), në partneritet me Institutin Kombëtar për Demokraci (NDI), ka organizuar të hënën një tryezë diskutimi me temën "Zgjedhjet dhe teknologjia: ndikimi në demokracinë moderne".

Në këtë ngjarje morën pjesë ekspertë, politikëbërës dhe përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët shqyrtuan sfidat dhe mundësitë që ofrojnë inovacionet teknologjike, përfshirë aspekte të sigurisë, transparencës dhe besimit të publikut.

Në një kohë kur teknologjia po transformon thellësisht çdo aspekt të procesit zgjedhor, qëllimi i këtij diskutimi është t'i

shqyrtojë sfidat dhe ndikimin e saj në transparencë, angazhimin e votuesve dhe sigurinë, si dhe të analizohet si përparimet e reja teknologjike po ndikojnë në këto fusha.

Ish-drejtori i NDI në Kosovë, Carlo Binda, tregoi përfitimet e përdorimit të inteligjencës artificiale në procesin zgjedhor, mirëpo shtoi se për të siguruar që ai nuk minon bazat e demokracisë, duhet të vendosen kornizat adekuate ligjore.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Adnan Rrustemi, tha se megjithëse digjitalizimi ndihmon procesin zgjedhor, kjo e fundit nuk guxon tërësisht të varet nga teknologjia. Ndërkaq shefi i grupit



parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Ableard Tahiri, tha se digjitalizimin e administrimit zgjedhor e kanë pasur prioritet në reformën e miratuar zgjedhore. "Ajo çka

ofron teknologjia, mënyra e regjistrimit, e votimit, e numërimit të votave, është shumë më e avancuar sesa ka qenë para një dekade", theksoi Tahiri.

Pjesëmarrës në këtë tryezë ishte edhe zëdhënësi i Komisionit Qendror Zgjedhor, Valmir Elezi, i cili tha se ky institucion ka arritur t'i digjitalizojë shumë nga operacionet zgjedhore për zgjedhjet e 9 shkurtit.

Ky aktivitet është realizuar me mbështetjen e projektit rajonal "SMART Balkans - Shoqëria civile për vlera të përbashkëta në Ballkanin Perëndimor" të zbatuar nga Centar za promociju civilnog društva (CPCD), Qendra për Kërkim dhe Politikëbërje (CRPM) dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme Norvegjeze (NMFA).

Përurohen investimet në shkollën "Metush Krasniqi" në Roganë të Kamenicës

KAMENICË, 16 SHTATOR - Kryeministri Albin Kurti mori pjesë në përuroren e investimeve në Shkollën Filllore dhe të Mesme e Ulët "Metush Krasniqi" në Roganë të komunës së Kamenicës.

Investimet e bëra mbi 1 milion euro në hapësirën e brendshme të shkollës, në pjesën e jashtme si dhe në inventar, siç deklaroi kryeministri Kurti, do të krijojnë kushte të shkëlqyera për 197 nxënësit, si dhe stafin prej 39 punonjësve arsimorë dhe profesionalë. "Me vlerë prej mbi 1 milion euro, ky projekt përfshin përmirësime të thella në hapësirat e brendshme, në vlerë prej 850 mijë eurosh dhe 165 mijë euro për



pjesën e jashtme të shkollës, si dhe 36 mijë euro për inventarin e ri për mësim cilësor", njoftoi kryeministri Kurti.

Më tutje shtoi ai, MASHTI dhe komuna e Kamenicës do të ndërtojnë në këtë komunë edhe dy çerdhe të reja, përfshirë një në Roganë dhe tjetra në Koretinë në vlerë prej 741 mijë eurosh, e cila është duke u ndërtuar dhe pritet të hyjë në funksion shumë shpejt.

Pas prerjes së shiritit dhe përfundimit të fjalës, kryeministri Kurti pa nga afër ambientet e brendshme, ekspozitën me punimet e nxënësve të shkollës të paraqitura në hollin e kësaj shkolle si dhe kabinetet ku ndoqi

performancën e nxënësve.

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, tha se të jemi sot bashkë këtu është kënaqësi dhe përgjegjësi. "Kënaqësi, sepse po përurojmë objektin e ri të shkollës 'Metush Krasniqi'. Përgjegjësi, sepse si qeveri dhe ministri mundohemi të kryejmë më së miri detyrën tonë duke qenë pranë jush dhe krijuar kushte për arsim cilësor", tha Nagavci.

Ndërkaq, kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, tha se fokus i kësaj komune do të mbetet arsimi, prandaj edhe investimi në këtë shkollë ka qenë i domosdoshëm.

Kosova kërkon nga Hungaria ta ndihmojë në anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë, në kryesimin e Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, kryetare e këtij Komisioni, priti të hënën në takim ambasadorin e Republikës së Hungarisë në Kosovë, Bela Boszik. Kryetaria e Komisionit, Kryeziu-Hyseni, pasi vuri në theks mbështetjen dhe përkrahjen e gjertanishme të Hungarisë, po ashtu vuri në dukje rëndësinë e

përkrahjes së mëtejme të Kosovës në procesin e integritetit të saj në BE dhe në NATO.

Kërkojmë, tha në vijim kryetaria e Komisionit, Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, që Hungaria si kryesuese e Presidencës së BE, të bëjë edhe më shumë për anëtarësimin e vendit tonë në organizatat ndërkombëtare.

Kryetaria e Komisionit nënvizoi të arriturat e vendit tonë, me theks të



veçantë reformat të cilat avancojnë Kosovën në rrugën e saj të integritetit.

Ambasadori Bela Boszik, pasi falënderoi për pritjen, foli për marrëdhëniet ndërshtetërore, për të cilat tha se duhet thelluar edhe më tej, në frymën e një uniteti evropian.

Republika e Hungarisë tha ambasadori Boszik vazhdon ta mbështesë edhe më tej Kosovën, duke vënë në dukje me këtë rast pjesëmarrjen hungareze në KFOR, si dhe numrin e madh të

studentëve kosovarë në Hungari.

Në vijim ambasadori Boszik foli për prioritetet e BE-së në kryesimin e shtetit që ai përfaqëson, ndërkaq vuri në pah edhe sfidat me të cilat është duke u ballafaquar BE. Në vazhdim të takimit u ngritën çështje me interes për të dyja vendet, ndërsa u konstatua se dialogu mbetet mënyra më e mirë për tejkalimin e sfidave dhe integrimin e gjithë rajonit.

Hamza takon ambasadorin e Finlandës: Kosova të gjitha sfidat i ka përballuar dhe tejkaluar me përkrahjen e aleatëve

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Kandidati i PDK-së për kryeministër të Kosovës, Bedri Hamza, ka njoftuar se të hënën është takuar me ambasadorin e Finlandës, Matti Nissinen. Hamza ka thënë se Finlanda është mike e Kosovës dhe përkrahëse e madhe e integritetit

euroatlantik. "Ditën e sotme e nisa me një takim me ambasadorin e Finlandës, Matti Nissinen. Finlanda është një mike e Kosovës dhe një përkrahëse e madhe e integritetit tonë euroatlantik. Ne biseduam për zhvillimet politike në vend, për rritjen e bashkëpunimit ndërshtetëror

dhe për sigurinë, paqen dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor. Kosova, të gjitha sfidat e deritashme, duke u bërë partnere konstruktive, i ka përballuar dhe i ka tejkaluar me përkrahjen e aleatëve!", ka shkruar Hamza në "Facebook".



Osmani takon kreun e BIK-ut: Kosova po vazhdon ta mbajë lart nivelin e tolerancës dhe harmonisë ndërfaqetare

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të hënën në takim kreun e Bashkësisë Islame të Kosovës, Naim Tërnavë.

Presidenca ka njoftuar se në takim është diskutuar për angazhimin e Bashkësisë Islame për forcimin e pozitës ndërkombëtare të Kosovës, traditën e tolerancës

ndërfaqetare dhe nevojës për vazhdimin e kultivimit të saj. Presidentja Osmani shprehu vlerësimin e thellë për përpjekjet e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK) për dialog, mirëkuptim dhe unitet ndërmjet të gjithë komuniteteve fetare në Kosovë. “Në një kohë ku paqja dhe mirëkuptimi global janë më të rëndësishme se

kurrë, Kosova është krenare që vazhdon ta mbajë lart nivelin e tolerancës dhe harmonisë ndërfaqetare”, ka theksuar Osmani.

Në takim u potencua roli jetik i të gjitha bashkësive fetare dhe nevoja e një angazhimi të përbashkët kundër gjuhës së urrejtjes dhe në favor të tolerancës, mirëkuptimit dhe respektit të ndërsjellë.



Kurti: Agresioni i Rosisë ndaj Ukrainës ka shpërfaqur rreziqet që regjimet autoritare paraqesin për shtetet fqinje

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Kryeministri Albin Kurti bashkë me ministrin për Komunitete dhe Kthim, Nenad Rashiq, mirëpritën në Prishtinë për një mëngjes pune bashkëthemeluesin dhe ish-udhëheqësin e Lidhjes së Social Demokratëve të Vojvodinës, Nenad Čanak, i shoqëruar nga Mitropoli i Kishës Ortodokse të Malit të Zi, Boris Bojović.

Në njoftimin e lëshuar për medie thuhet se gjatë bisedës u diskutua mbi çështje aktuale, zhvillimet në rajon, pasojat e vazhdueshme të agresionit ushtarak rus në Ukrainë dhe rrezikun që lufta atje vazhdon të paraqesë për sigurinë e kontinentit të Evropës dhe rajonin e Ballkanit. “Millan Čanak, djali i Nenad Čanak që, po ashtu, ishte në këtë takim, e i cili së fundmi është kthyer nga një mision humanitar në Ukrainë, ndau rrëfime nga përvoja e tij atje dhe foli për gjendjen në terren, trimërinë dhe moralin e lartë të ushtrisë

ukrainase në fushëbetejë dhe për mobilizimin qytetar për rezistencë. Në takim u diskutua edhe për raportet e Kosovës me Serbinë, për historikun, aktualitetin dhe perspektivën e tyre, edhe për gjendjen e pakicës serbe në Kosovë”, thuhet në njoftim.

Ndër të tjera, theksohet se Kurti tha se agresioni i Rosisë ndaj Ukrainës ka shpërfaqur qartë rreziqet që regjimet autoritare paraqesin për shtetet fqinje, përveçse për të drejtat e njeriut dhe mirëqenien e popullatës vendëse. Ai veçoi rëndësinë që demokratizimi i shoqërive, pluralizmi partiak, sundimi i ligjit, mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut dhe bashkëpunimi rajonal kanë në përballje me këto rreziqe krahas mbështetjes së vazhdueshme ndaj Ukrainës në luftën e saj çlirimtare, të cilën Republika e Kosovës po e mbështet fuqishëm me gjithë kapacitetet e saj.



FSK-ja vazhdon ushtrimet për mbrojtjen e territorit të Kosovës



PRISHTINË, 16 SHTATOR - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka njoftuar se në kuadër të ushtrimit “Arrow Delta 01”, togu i rikonicionit dhe togu i mortajave nga Regjimenti i Tretë i Këmbësorisë janë duke demonstruar testimin e kapaciteteve të tyre për mbështetjen e operacioneve mbrojtëse dhe aftësive të liderëve kyçë.

Duke shpërndarë disa fotografi të ushtarëve në rrjetin social “Facebook”, ministri thotë se, krahas furnizimit me pajisje dhe sisteme të armatimit, trajnimi dhe testimi i shkathtësive individuale dhe ekipore janë shtylla tejet të rëndësishme për zhvillimin e aftësive luftarake të njësisë të FSK-së. “Me qëllim që të jetë e aftë për ta

ushtruar njëri nga tre detyrat kyçe të misionit të saj, mbrojtjen e territorit, Forca e Sigurisë së Kosovës po vazhdon përgatitjen dhe trajnimin e njësiteve të saj.

Në kuadër të ushtrimit “Arrow Delta 01”, togu i rikonicionit dhe togu i mortajave nga Regjimenti i Tretë i Këmbësorisë janë duke demonstruar testimin e kapaciteteve të tyre për mbështetjen e operacioneve mbrojtëse dhe aftësive të liderëve kyçë. Krahas furnizimit me pajisje dhe sisteme të armatimit, trajnimi dhe testimi i shkathtësive individuale dhe ekipore janë shtylla tejet të rëndësishme për zhvillimin e aftësive luftarake të njësisë të FSK-së”, ka njoftuar Maqedonci.

Edita Tahiri: Efektet e para të vizitës së shefit të CIA-s, Kurti harroi hapjen e Urës së Ibrit

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Ish-kryenegociatorja e Kosovës në dialogun me Serbinë, Edita Tahiri, ka thënë se efektet e para

të vizitës së shefit të CIA-s janë se Kurti harroi hapjen e Urës së Ibrit, ndërsa Vuçiqi harroi vazhdimin e bojkotit. “Efektet e

para të vizitës së shefit të CIA-s - Kurti harroi hapjen e Urës së Ibrit, ndërsa Vuçiqi harroi vazhdimin e bojkotit, ftoi serbët

të kthehen në institucionet e Kosovës, ka efekte edhe më strategjike që po ndodhin”, ka shkruar Tahiri në “Facebook”.



Çmimet e produkteve të ndryshme ushqimore vazhdojnë të jenë të lartë

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Qytetarët po ankohen për çmime të larta e Agjencia e Statistikave të Kosovës ka bërë me dije se çmimet janë rritur për 1.4 për qind krahasuar me muajin gusht të

këtij viti. Çmimet e produkteve të ndryshme ushqimore në Kosovë vazhdojnë të jenë të larta, madje edhe të papërbalueshme. Kështu thonë për RTK-në qytetarët.

Edhe Agjencia e Statistikave e Kosovës ka njoftuar se çmimet e konsumit kanë shënuar rritje prej 1.4-përqindësh krahasuar me muajin gusht të vitit 2023. Kjo, sipas ASK-së, është

shpjeguar me ngritjen e çmimeve të pemëve, biletave të avionëve, lëndëve djegëse të ngurta, ujit mineral, bukës, drithërave dhe disa produkteve të tjera ushqimore.



Rekrutimi për pozita të larta, "CorrWatch" kritikon Ministrinë e Financave dhe atë të Tregtisë

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Iniciativa "CorrWatch", konsorcium i organizatave të shoqërisë civile (GLPS, GAP dhe INDEP), ka shprehur shqetësim të thellë për mbyllje dhe mungesë të transparencës nga Ministria e Financave dhe Ministria e Tregtisë për proceset rekrutuese për pozita të larta.

CorrWatch ka thënë se MF dhe MINT nuk janë transparente në përzgjedhjen për pozitat e larta të drejtorit ekzekutiv i Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) në kuadër të MINT, sekretar i përgjithshëm në MFPT, drejtor ekzekutiv në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, drejtor ekzekutiv në Agjencinë Qendrore e Prokurimit (AQP). "CorrWatch

ka bërë kërkesë për monitorimin e këtyre pozitave, por nuk jemi njoftuar për asnjërën fazë të procedurës për pozitat e lartceкура. Në rastin e drejtorit ekzekutiv në Agjencinë e Punësimit, CorrWatch është njoftuar që njësi përgjegjëse është duke pritur përgjigje nga ministri i MFPT. Për pozitën e drejtorit ekzekutiv në AQP dhe sekretarit të përgjithshëm në MFPT, CorrWatch nuk ka marrë asnjë përgjigje si dhe nuk është njoftuar për ta monitoruar procesin. Në MINT janë përgjigjur se do të lejohet monitorimi vetëm në fazën e verifikimit paraprak. Megjithatë, edhe përkundër konfirmimit, CorrWatch nuk është ftuar për monitorimin e fazën e verifikimit



paraprak. Mohimi i përfshirjes së shoqërisë civile nga MFPT dhe MINT është i kundërligjshëm, cenon garancitë e dhëna me ligj si dhe transparencën si njëra nga

shtyllat kryesore të meritokracisë. Një praktikë e tillë rrezikon që këto procese të mbyllura të jenë subjekt i ndikimeve politike dhe personale, duke minuar kështu

besimin e qytetarëve në institucionet publike", thuhet në reagimin e "CorrWatch"-it.

Projekti CorrWatch "Mbështetje për Shoqërinë Civile për ta Rritur Mbikëqyrjen Publike dhe Llogaridhënien e Institucioneve Publike të Kosovës" zbatohet nga Group for Legal and Political Studies, Instituti GAP dhe Institute for Development Policy (INDEP) dhe financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit përmes British Embassy Pristina. Përmbajtja e këtij reagimi është përgjigje e vetme e organizatave zbatuese dhe nuk i reflekton qëndrimet e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit të Mbretërisë së Bashkuar.

Inflacioni ndikon në rritjen e kostos së ndërtimit në Kosovë

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës ka publikuar Indeksin e kostos së ndërtimit për tremujorin e dytë të këtij viti. Sipas saj, niveli është rritur për 3.9 për qind.

Shtëpinë nuk ka ende një vit që ka nisur ta ndërtojë. E shpenzimet i kanë dalë jashtë pritshmërive.

Një banor nga qyteti i Obiliqit, që nuk dëshiroi të flasë para kamerës, thotë se çmimet e materialeve ndërtuese e të nevojshme për shtëpinë e vet janë rritur, njëherësh kanë kaluar pritshmëritë. "Para disa viteve, shtëpia dy kate më ka kushtuar rreth 12 mijë euro, ndërsa sot vetëm një kat rreth 30 mijë euro. Rreth 45 cent blloku, 1.50 tjegullat, 75 euro betoni dhe rreth 8.50 euro armatura", tregon ai për RTV Dukagjinin.

E se kostoja e ndërtimit është rritur e thotë edhe një raport i realizuar nga ASK. Sipas këtij raporti, krahasuar me vitin 2023,



në tremujorin e dytë të këtij viti, rritje e indeksit të ndërtimit është shënuar për 3.9 për qind. "Indeksi i tërësishëm i Kostos së Ndërtimit

në Kosovë (IKN) pati rritje për 3,9 % në tremujorin e dytë (TM2 2024), krahasuar me tremujorin e dytë (TM2 2023). Rritje më të

madhe kishte te pagat (16,8 %), transporti (6,3 %), kostot e tjera (2,4 %) dhe materialet (2,0 %). Ndërsa rënie pati te energjia (-2,1

%) dhe makineritë (-1,3 %)", njofton ASK-ja.

Sipas ish-kryetarit të Odës Ekonomike, e gjithë ky shkak i inflacionit. "Përveç materialeve bazike në ndërtimtarë dhe ngritjes së çmimit të tyre, kemi edhe ngritje të fuqisë punëtore, të kostos së saj dhe kësaj i shtohet edhe një fakt, kemi material të importuar nga pjesa dërrmuese e importit që përcillet me inflacion, çka e bën koston e ndërtimit tejet të shtrenjtë. Duhet të gjendet një modalitet që ky sektor të mbështetet, sepse nëse nuk është në monitorim do të kemi dëmtim të këtij sektori", ka thënë ekonomisti Safet Gërxhaliu.

E si zgjidhje Gërxhaliu sheh nevojën për më shumë investime e gatishmëri nga bankat. Vitin e kaluar indeksi i tërësishëm i kostos së ndërtimit në Kosovë pati rritje për 0.4 për qind në tremujorin e tretë të vitit 2023, krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2023.

Në 30 trafo të Veternikut po bëhet konvertimi i linjave nga 10kV në 20kV

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Në kuadër të planit investiv po bëhet konvertimi i linjës nëntokësore nga 10kV në 20kV në Daljen 2 Veterniku, e cila përfshin mbi tridhjetë trafo në një pjesë të Veternikut, Çagllavicës përgjatë

magjstrales Prishtinë - Ferizaj. Si një projekt kapital, ky investim sjell përfitime të rëndësishme për konsumatorët. Me dyfishimin e kapacitetit të linjës nga 10kV në 20kV, konsumatorët tanë në këtë pjesë-kryesisht komerciale,

por edhe shtëpiake do të kenë stabilitet të lartë dhe cilësi të furnizimit me energji elektrike. Konvertimi i kësaj linje është një hap i rëndësishëm drejt një rrjeti modern, të cilin KED-iS po e implementon gjithandej nëpër Kosovë.

Në të njëjtën zonë të Prishtinës javën e kaluar është bërë konvertimi i linjës 10kV në 20kV në rreth pesëdhjetë trafo, ndërkaq së shpejti pritet që e njëjta të bëhet edhe në rreth njëzet trafo të tjera në daljen "Rezonanca".



Wikipedia po përballet me një krizë ekzistenciale: A mund ta shpëtojë brezi Z?

Nga: Stephen HARRISON,
gazetar që trajton temat e
teknologjisë dhe autor i romanit
Redaktorët [The Editors] që është
frymëzuar nga Wikipedia / The
Guardian

Themeluar në vitin 2001, Wikipedia tashmë është një "plak" sipas standardeve të internetit. Por, mbetet befasues roli që luan në njohuritë tona kolektive për botën. Përmbajtja nga enciklopedia e lirë e internetit shfaqet në çdo gjë, nga punimet e maturës së shkollës së mesme dhe pyetjet triviale në pijetore, e deri te përmbledhjet e motorëve të kërkimit dhe asistentët zanorë. Mjetet si AI Overviews nga Google dhe ChatGPT mbështeten shumë në Wikipedia, megjithëse rrallëherë e vlerësojnë faqen në përgjigjet e tyre.

Dhe, këtu qëndron problemi: derisa dukshmëria e Wikipedia-s po zvogëlohet, duke u reduktuar në të dhëna të thjeshta trajnimi për aplikacionet e inteligjencës artificiale [AI], ajo gjithashtu humb rëndësinë në mendjet e lexuesve dhe kontribuuesve të mundshëm. Kur dikush vëren një temë që përshkruhet keq në Wikipedia, ai mund të ndihet i motivuar për ta korrigjuar. Por, ky vullneti për të sfiduar mund të tretet kur gabimi vjen përmes një përmbledhjeje të AI-së, ku burimi i informacionit nuk është i qartë.

Në Katovicë të Polonisë, në konferencën vjetore të vikimaniës [Wikimania] në muajin e kaluar – një ngjarje që ndihet paksa si samit ndërkombëtar i bibliotekarëve – shumë nga folësit theksuan se si Wikipedia përballet me një kërcënim ekzistencial për t'u zhdukur në errësirë ose në gjendje të vështirë. Por, u fol gjithashtu për një zgjidhje që mund të ndihmojë në sigurimin e së ardhmes së Wikipedia-s, ose të paktën të parandalojë shkatërrimin e saj të parakohshëm: rekrutimi i më shumë redaktorëve të rinj nga brezi Z dhe rritja e ndërgjegjësimit të tyre se sa gjerësisht përdoret përmbajtja e Wikipedia-s në internet.

Wikipedia funksionon sipas një modeli të vullnetarëve të papaguar dhe të pavarur që krijojnë, përditësojnë dhe mirëmbajnë përmbajtjen. Redaktorët e rastësishëm mund të bëjnë modifikime të vogla stilistike në një faqe, ndërsa të tjerët i kushtojnë kohë të konsiderueshme krijimit të artikujve të plotë. Një numër i konsiderueshëm i kontribuuesve të Wikipedia-s janë tashmë nga brezi Z; sipas një sondazhi të vitit 2022, rreth 20 për qind e redaktorëve të Wikipedia-s janë mes moshës 18 dhe 24-vjeçare. Edhe pse kjo reflekton përafërsisht



popullsinë globale, ekziston një dëshirë e qartë për të rritur këtë përqindje.

Si autor për teknologjinë, dhe gjatë kërkimit tim të Wikipedia-s për romanin tim Redaktorët [The Editors], shpeshherë kam dëgjuar të njëjtat çështje që e pengojnë brezin e ri të bashkohet me kauzën. Së pari dhe më kryesorja, celulari inteligjent është pajisja e preferuar e qasjes në internet të brezit Z, por nuk është mjet i lehtë për të redaktuar Wikipedia-n. Edhe ai që e njih shumë mirë teknologjinë digjitale, e ka të vështirë të redaktojë enciklopedinë me një ekran të vogël.

Ka përjashtime. Hannah Clover, një kanadeze 22-vjeçare, ishte fituesja më e re deri tash e "Wikimedianit të Vitit" në vikimaniën e muajit të kaluar. Ajo gjithashtu është një specie e rrallë: një vikipediane shumë punëtore që ka bërë më shumë se 75 për qind të redaktimeve të saj duke përdorur celularin. Shumë prej tyre ishin modifikime që ajo bëri në lëvizje, ndërsa udhëtonte në autobus ose gjatë pushimeve të ndërrimeve në punën e saj të mëparshme në McDonald's. Për Cloverin, bashkimi në enciklopedinë globale ndihmoi në ofrimin e një kuptimi për qëllim. "Të shërbesh akullore për njerëzit, kjo nuk është në të vërtetë një përpjekje për të ndryshuar botën", më tha ajo. Clover ka rekomanduar përmirësime në aplikacionin mobil të Wikipedia-s, duke përfshirë aftësinë për të krijuar artikuj të rinj dhe një editor vizual që nuk kërkon aftësi kodimi. Një tjetër pengesë për tërheqjen e

kontribuuesve të gjeneratës Z është se Wikipedia e sotme është thjesht më e ngritur. Steven Pruitt është një legendë e Wikipedia-s, me numrin më të madh të redaktimeve të bëra në Wikipedia në anglisht, në më shumë se pesë milionë raste. Tani 40 vjeç, Pruitt tha se kur filloi për herë të parë redaktimin, 20 vjet më parë, projektin ndihet si një territor i paeksploruar: ai kishte liri të konsiderueshme për të krijuar artikuj të rinj. Sot, me kaq shumë faqe që veçse ekzistojnë, ka më pak mundësi për të shtuar përmbajtje të reja. Kjo do të thotë se brezi Z duhet t'i qaset Wikipedia-s jo si një perëndim i egër interesant, por si një institucion që mund të përmirësohet gradualisht. Megjithatë, është më e vështirë për redaktorët e rinj që të gjejnë rrugën e tyre. Gjeneratat e mëparshme në shumë raste filluan duke bërë redaktime të vogla, si rregullimi i gabimeve drejtshkrimore ose evidentimi i vandalizmave, por në ditët e sotme shumë nga këto detyra trajtohen nga mjetet e automatizuara. Pa pika të qarta për hyrje, redaktorët e rinj mund të zhyten në redaktimin e artikujve më të diskutueshëm, ku një hap i vetëm i gabuar mund të shkaktojë reagime të ashpra. Vikipedianët me përvojë nuk njihen si të këndshëm: nëse një redaktor i vjetër poston komente të shkurtra dhe vërejtje në faqen e diskutimit të një përdoruesi të ri (ku redaktorët diskutojnë përmirësimet e artikujve), natyra publike e kritikës mund të jetë njaft e turpshme saqë dekurajon


të sapoardhurin nga vazhdimi i punës si vullnetar i rregullt.

Ashtu si të tjerët në grupin e saj, Cloveri lindi pasi u themelua Wikipedia, kështu që imazhi i saj mendtor për enciklopedinë është formuar më shumë nga Wikipedia sesa nga raftet e Encyclopaedia Britannica-s me kopertina lëkure. Ky dallim brezash shtrihet në normat e komunikimit. Cloveri dhe bashkëmohatarët e saj shpeshherë angazhohen në platforma bisedash si Discord, ndërsa disa vikipedianë më të vjetër preferojnë t'i mbajnë debatet të kufizuara në faqet e diskutimit të Wikipedia-s, ku bisedat janë më të fokusuara dhe më pak sociale. Cloveri beson se ofrimi i më shumë mundësive për ndërveprim social është thelbësor për ndërtimin e një ndjesi të përkatësisë në komunitet dhe qëllimit të përbashkët mes redaktorëve të rinj. Siç tha ajo: "Kur je i ri, mund të ndihesh sikur gjithçka që po bën po shkon në një boshllëk të madh".

Derisa gjeneratat e ndryshme përfundimisht mund të gjejnë gjuhën e përbashkët, marrëdhënia e ardhshme midis redaktorëve njerëzorë dhe AI-së mbetet e pasigurt. A do të zëvendësojë AI-ja përfundimisht vullnetarët njerëzorë? Le të shpresojmë që jo. Përpilimi i një enciklopedie kërkon gjykim që kuptohet më mirë nga njerëzit të cilët njohin kontekstin social. /Telegrafi/ Fortunately, gen Z doesn't seem inclined to immediately surrender Wikipedia to AI. During an online debate last year about whether Wikipedia editors should incorporate chatbot-generated

content, several young contributors urged caution, pointing out how large language models often produce errors and fail to cite sources accurately. And beyond AI's shortcomings, there is a great human benefit to young people's increased participation in the world's most important knowledge platform. As a generation that is overall very cynical about media and institutions, contributing to Wikipedia allows them to channel their concerns into something constructive. Gen Z may still have plenty of criticisms of old institutions like Wikipedia, but at least they will have got involved.

Për fat të mirë, brezi Z nuk duket i prirur që t'ia dorëzojë shpejt Wikipedia tek AI-a. Gjatë një debati në internet, vitin e kaluar, nëse redaktorët e Wikipedia-s duhet të përfshijnë përmbajtje të krijuar nga chatbotët, disa kontribuues të rinj kërkuan kujdes, duke vënë në dukje se si modelet e mëdha gjuhësore shpeshherë bëjnë gabime dhe nuk arrijnë të citojnë me saktësi burimet. Dhe, përtej mangësive të AI-së, ka një përfitim të madh njerëzor nga rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në platformën më të rëndësishme të njohurive në botë. Si një gjeneratë që është në përgjithësi shumë cinike për mediat dhe institucionet, kontributi në Wikipedia i lejon ata të kanalizojnë shqetësimet e tyre në diçka konstruktive. Brezi Z mund të ketë ende shumë kritika ndaj institucioneve të vjetra si Wikipedia, por të paktën ata do të jenë përfshirë. /Telegrafi/



Berisha: Nuk e prisja të isha titullar ndaj Torinos

Lecce, 16 shtator - Mesfushori shqiptar i Lecces, Medon Berisha, ka folur në zonën mikse, në fund të ndeshjes së mbyllur në barazim ndaj Torinos. “Është një pikë e mirë, por brenda vetes kemi bindjen se mund të kishim fituar”, ka

thënë mesfushori shqiptar, i cili luajti ndeshjen e parë si startues në këtë kampionat. “Në qendër të mesfushës mund të shprehem më mirë, shkoj mirë me shokët e skuadrës dhe e lexojmë mirë lojën”. Një titullar disi befasues: “Në

stërvitje, gjithmonë përpiqem të jap më të mirën time, besoj po shpërblehem për këtë. Kur jep më të mirën, kënaqësia vjen natyrshëm”. I pyetur se a e dinte se do të luante titullar, Berisha është përgjigjur: “Unë jam gjithmonë gati, është e

rëndësishme të jem në dispozicion të trajnerit. Kisha luajtur pak para kësaj ndeshjeje, por nuk ishte problem. Jemi një ekip cilësor, ka konkurrencë të madhe. Tani duhet të sigurojmë vazhdimësi”.



Sporti, mjet thelbësor për zhvillimin e demokracisë

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Sporti është mjet thelbësor për zhvillimin e demokracisë në Kosovë, por edhe për njohjen dhe ndërkombëtarizimin e shtetësisë së Kosovës. Kështu është thënë në panelin e diskutimit me temë “Sporti dhe demokracia: Një vizion i ri për të ardhmen”. Me këtë rast, ish-drejtori i NDI në Kosovë, Alex Chavarria, në fjalën e tij potencoi rëndësinë e madhe që sporti ka për zhvillimin e demokracisë përmes aktiviteteve të ndryshme që sjellin bashkimin e njerëzve dhe thyen barrierat të mëdha ndërmjet tyre. “Është shumë me rëndësi të shohim se sa i rëndësishëm është roli i zhvillimit të demokracisë. Sporti i bashkon njerëzit, i rrezon barrierat sociale dhe promovon përfshirjen dhe barazinë. Mendoj që këtë nuk e kuptojmë sa duhet në jetën tonë të përditshme... Si i



tillë, nuk ka dyshim se sporti ka ndikim të thellë në demokracinë e Kosovës, është ndjenjë e krenarisë nacionale, kombëtare, që mund të krijohet nga ndërveprimi sportiv sepse kështu

duhet të veprojmë me shoqërinë... Sporti ia ka dhënë mundësinë Kosovës të njihet ndërkombëtarisht gjithashtu dhe që atëherë kanë qenë tri Lojëra Olimpikë që kur Kosova është

bërë pjesë dhe nëse kam numëruar mirë, i keni pesë medalje të arta”, theksoi ai. Ndërsa deputetja e Kuvendit të Kosovës, Elixha Hoxha, ka vënë në pah rëndësinë që ka sporti për imazhin e Kosovës jashtë vendit, duke e arritur këtë në formën më të mirë përmes sukseseve të mëdha në garat sportive ndërkombëtare. “Nëse flasim për kulturë dhe për sport, zakonisht Kosova ndryshon në sytë e të tjerëve si imazh dhe si brend i një shteti të ri për shkak të sukseseve që kjo kategori e njerëzve ose kjo platformë sportive u krijon mundësi edhe të rinjve, por edhe krijon një pikëpamje të re dhe një mundësi të re të leximit të potencialit të shtetit se çfarë mund të jetë nga brenda dhe çfarë mund t’i japë Evropës dhe botës një shtet me një shoqëri shumë të re”, theksoi Hoxha.

Ndërsa kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës kërkoi më shumë gjithëpërfshirje të grave në vendimmarrje nëpër federatat sportive, duke theksuar se FBK-ja është shumë e përkushtuar në këtë drejtim. “Ne e kemi këtu deficitin si vend jo vetëm në basketboll, por në të gjitha sportet. Ne kemi vendosur që ato t’i subvencionojmë në të gjitha nivelet. Prej garave shkollore që organizohen si pjesë e programit ‘Sporti në shkollë’ e deri te garat seniore, nëse merresh me basketboll në Kosovë, nuk do të paguash asgjë. Kjo ishte për ta trajtuar çështjen e barazisë gjinore dhe të gjithpërfshirjes si parime të tjera të demokracisë. Masat stimuluese janë aty jo vetëm për femrat, masat stimuluese kemi edhe për të rinj, por edhe për veteranë”, ka thënë Fetahu.

FFK-ja ankohet në KPM, AGK e ShGSK: Një grup i interesit po tenton ta marrë kontrollin e federatës

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Federata e Futbollit të Kosovës (FFK) nëpërmjet një letre të hapur dërguar Komisionit të Pavarur të Medieve (KPM), Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës (AGK) dhe Shoqatës së Gazetarëve Sportivë të Kosovës (ShGSK) është ankuar se në disa emisione sportive të televizioneve në Kosovë po bëhet fushatë mediale nga një grup i vogël interesi, me qëllim që ta marrin kontrollin mbi Federatën e Futbollit të Kosovës. “Federata e Futbollit të Kosovës me shqetësim të thellë ka përcjellë zhvillimet e fundit në skenën mediale dhe luftën speciale të disa emisioneve sportive ndaj FFK-së. Fushata mediale kundër Federatës së Futbollit të Kosovës dhe

Kombëtares së Kosovës në Futboll tashmë ka kaluar çdo normë dhe etikë të gazetarisë profesioniste, norma të cilat mediumet dhe emisionet përkatëse janë të obliguara edhe ligjërisht për t’i respektuar. Mediumet dhe emisionet e tilla janë shndërruar në platforma të promovimit të individëve që nuk kanë asnjë lidhje me futboll dhe janë pa integritet profesional e moral dhe të cilët kanë agjendë të hapur kundër Federatës së Futbollit të Kosovës dhe Kombëtares së Kosovës në Futboll. Dhënia e hapësirës për individë që në asnjë formë nuk kanë asnjë lidhje me futbollin, promovimi i një fushate të tillë kundër Federatës së Futbollit të Kosovës, ofendimet dhe linçimet



publike, shpërfaqin haptas unifikimin e disa emimeveve e emisioneve sportive dhe të një grupi të vogël interesi, rreth qëllimit të tyre të vetëm, që në mënyrë jolegjitime, por nga studiot televizive, ta marrin kontrollin mbi Federatën e Futbollit të Kosovës. Federata e Futbollit të Kosovës njofton opinionin publik se

asnjëherë nuk do të bie pre e asnjë presioni të pabazë nga individë që interesin e një grupi të caktuar e vendosin mbi interesin e futbollit të vendit tonë. Politika e zhvillimit të futbollit të Kosovës bëhet në zyrat e Federatës së Futbollit të Kosovës”, thuhet në letrën e FFK-së. FFK-ja ka potencuar se zgjedhja e organeve drejtuese të institucionit kryesor të futbollit bëhet në formë legjitime në Kuvendin e Federatës nga protagonistët e fushës, përkatësisht delegatët e zgjedhur nga klubet dhe organet e tjera të jetës futbolistike në Kosovë, e assesi nga studiot televizive e as nga individë pa kredibilitet në futboll, por edhe në përgjithësi në jetën publike në Kosovë. “FFK-ja

kërkon nga Komisioni i Pavarur për Media, nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, nga Shoqata e Gazetarëve Sportivë, si dhe nga organet drejtuese të emimeve, që të reagojnë dhe të mos lejohen fyerjet, shpifjet, shantazhet dhe kërcënimet qoftë ndaj FFK-së e zyrtarëve të saj, qoftë ndaj delegatëve, klubeve e zyrtarëve të tyre, si dhe të respektohen normat dhe etika e gazetarisë profesioniste. Në të kundërtën FFK-ja do të marrë masa ligjore ndaj emimeve në fjalë, ashtu siç do të veprojë ndaj individëve që vazhdimisht me vetëdije të plotë dhe për interesin e ngushtë kanë shkelur këto parime dhe rregulla”, thuhet në letrën e FFK-së.

Aro Muriq në formacionin e javës në Angli

Londër, 16 shtator - Arijanet Muriq ka vazhduar shkëlqimin në elitën e futbollit anglez - Ligën Premierë - me fanellën e Ipswich Town. Portieri nga Kosova ishte fantastik në fundjavë, pasi bëri

gjashtë pritje për skuadrën e tij Ipswich dhe morën një barazim të vlefshëm 0-0 në udhëtim te Brighton. Në fakt, reprezentuesi nga Kosova është lojtari me notën më të lartë në gjithë Ligën

Premiere për xhiron e katërt, pasi është vlerësuar nga Sofa Score 9,1 pas ndeshjes. Aro Muriq ka zënë vend edhe në formacionin më të mirë të javës, ku në të ka edhe emra të mëdhenj. Në

mbrojtje është Matthijs de Ligt, O’Shea dhe Gabriel. Ndërkohë në mesfushë janë Diallo, Lemina, Ndidi, McNeil dhe Davis. E dyshja e sulmit janë Haaland dhe Watkins.



Chelsea 'blindon' 14 futbollistë me kontrata afatgjatë

LONDËR, 16 SHTATOR - Nicolas Jackson është futbollisti i fundit që ka nënshkruar kontratë afatgjatë me Chelsea. Ai tani së bashku me Cole Palmer kanë kontratë që i lidh me klubin edhe për nëntë vitet e ardhshme. Me

ndryshimin e pronësisë, Chelsea ka marrë iniciativë për kontrata afatgjatë. Përveç Jackson e Palmer që kanë kontrata deri në vitin 2033, kapiteni Enzo Fernandez ka një vit më pak. Tani ka shkuar numri në 14 i futbollistëve që

kanë kontrata afatgjatë me Chelsea dhe londinezët duket se të ardhmen e kanë të garantuar. Futbollistët e Chelsea të cilët kanë kontrata afatgjatë: Nicolas Jackson (2033), Cole Palmer (2033), Enzo Fernandez (2032),

Mykhailo Mudryk (2031), Joao Felix (2031), Pedro Neto (2031), Moises Caicedo (2031), Renato Veiga (2031), Filip Jorgensen (2031), Noni Madueke (2030), Romeo Lavia (2030), Malo Gusto (2030), Benoit Badiashile (2030), Robert Sanchez (2030).



Sonte fillon Liga e Kampionëve me format të ri

MILANO, 16 SHTATOR - Sonte (e martë) merr jetë edicioni i ri i Ligës së Kampionëve. Një sezon unik do të jetë ky që do të nisë. 36 skuadra e jo më 32, në një grup unik, ku do ta kenë mundësinë të luajnë 8 ndeshje, 4 brenda fushe dhe 4 në transfertë, për të mësuar më pas se cili do të jetë fati i tyre për të vijuar më tej kompeticionin. 8 skuadrat e renditura më mirë në klasifikimin përfundimtar do të kalojnë më tej në fazën e zakonshme të 1/8 të finaleve. Skuadrat e renditura nga vendi i 9 në të 24 do të kalojnë në fazën e "play-off"-it e do të përballen me njëra-tjetrën për të përcaktuar se cilat do të jenë 8 ekipet e tjera që do t'u bashkëngjiten tetë skuadrave të kualifikuara nga faza e ligës, e që do ta formojnë kuadrin e plotë të 16 skuadrave për fazat me eliminim direkt. Megjithatë, duke qenë një format që do të aplikohet për herë të parë, me të drejtë të



gjithë shtrojnë pyetjen: Sa pikë i duhen një skuadre për ta siguruar kualifikimin për më tej? Kësaj pyetje së fundmi i është përgjigjur sistemi i quajtur "ELO" i cili ka bërë afro 10 mijë simulime, për të gjetur një mesatare të saktë. Kështu, sipas këtij sistemi, çdo skuadër mesatarisht duhet të grumbullojë 15 pikë nëse kërkohet të kualifikohet direkt në fazën e eliminim direkt, pra për t'u renditur në 8 skuadrat e para. Ndërkohë skuadra që do të renditet e 24, ose

e fundit që do ta ketë shansin të marrë pjesë në "play-off", duhet të grumbullojë mesatarisht 9 pikë. Sigurisht këto janë vetëm disa përlogaritje, pasi të gjithë presin me padurim të shohin se si do të jetë ky format i ri i këtij kompeticioni. Deri tani njohim vetëm faktin se që në fazën e Ligës së Kampionëve do të vendosë përballë emra të mëdhenj të futbollit botëror, të cilët padyshim do të na garantojnë emocione dhe spektakël.

TË MARTËN TAKOHEN:

18:45 Juventus - PSV Eindhoven
18:45 Young Boys - Aston Villa
21:00 AC Milan - Liverpool
21:00 Bayern Munchen - Dinamo Zagreb
21:00 Real Madrid - Stuttgart
21:00 Sporting - Lille

Sinneri dominon renditjen, Djokoviqi zbret në vendin e katërt



ROMË, 16 SHTATOR - Rënditja e përgjithshme në tenis nuk ka pësuar ndryshime të mëdha pas grand slam të US Open që u mbyll një javë më parë. Tenisti italian Jannik Sinner vijon të kryesojë për meshkuj. Ajo që bie

në sy është diferenca prej 4 mijë pikësh që ka me ndjekësit. Tashmë në vendin e dytë ndodhet gjermani Alexander Zverev, që ka parakaluar Alcaraz (i treti) e Djokoviqi (i katërti). Te femrat vijon të dominojë polakja

Iga Swiatek edhe ajo e shkëputur 3 mijë pikë nga Aryna Sabalenka, e dyta. Mes pesë tenisteve më të mira ka hyrë për herë të parë italiania Jasmine Paolini.

RENDITJA - MESHKUJ

1. Jannik Sinner	11.180 pikë
2. Alexander Zverev	7.075 pikë
3. Carlos Alcaraz	6.690 pikë
4. Novak Djokoviqi	5.560 pikë
5. Daniil Medvedev	5.475 pikë

RENDITJA - FEMRA

1. Iga Swiatek	10.885 pikë
2. Aryna Sabalenka	8.716 pikë
3. Jessica Pegula	6.220 pikë
4. Elena Rybakina	5.871 pikë
5. Jasmine Paolini	5.398 pikë

Bayerni me ofertë të re, Musiala e refuzon

Jamal Musiala e ka refuzuar ofertën e fundit për kontratën e re nga Bayern Munchen, duke ndezur spekulime intensive për të ardhmen e tij. Ylli gjerman është duke kaluar nëpër një formë të shkëlqyer dhe

drejtuesit e Bayernit po mundohen me çdo kusht ta vazhdojnë kontratën me të. Sipas medieve, Musiala po kërkohet një rritje të konsiderueshme të pagës, duke kërkuar 300 000 euro në javë

për ta nënshkruar marrëveshjen e re me Bayernin. Aktualisht Musiala fiton 2,6 milionë euro në vit, ndërsa me kontratën e re synon që të bëhet lojtari më i paguar në "Allianz Arena". Me

kontratën e tij aktuale që skadon në verën e vitit 2026, Musiala dhe Bayern po i afrohen një momenti kritik. Nëse kampionët gjermanë nuk arrijnë ta bindin atë të nënshkruajë një zgjatje brenda

12 muajve të ardhshëm, ata mund të detyrohen ta shesin atë për ta shmangur humbjen e tij falas. Real Madridi, Barcelona dhe top klubet angleze janë duke monitoruar situatën e mesfushorit gjerman.

SHKURT

Gjimshiti: Pësuam dy gola të shmangshëm, duhet t'i rishikojmë gabimet

Mbrojtësi kuqezi i Atalantës, Berat Gjimeshi, foli në konferencën pas fitores ndaj Fiorentinës (3-2). "Pësuam dy gola mjaft të shmangshëm. Sigurisht që duhet t'i rishikojmë. Si mbrojtës është e drejtë t'i shikojmë edhe gabimet. Jemi të lumtur, pas një kohe të gjatë që luajtëm sërish në shtëpi, është një shtysë e madhe që na dha publiku. Golat? Sigurisht që pësuam sërish një gol nga një top i vdekur, por nuk është çështje përqendrimi", ka thënë Gjimeshi. Mbrojtësi zikaltër foli më pas për ndryshimet e shumta në krahasim me sezonin e kaluar: "Është normale që disa lojtarëve u duhet pak më shumë kohë, por ne që kemi qenë më gjatë këtu do t'i ndihmojmë. Ne e dimë se çfarë dëshiron trajneri. Do të përpiqemi t'i ndihmojmë. Arsenalit? Ata që ndjekin futbollin evropian e njohin. Në vitet e fundit ka bërë një paraqitje të shkëlqyer. Është e vështirë të shënosh gola kundër tyre. Duhet ta shikojmë veten".

Flick: Yamal është i jashtëzakonshëm

Trajneri i Barcelonës, Hansi Flick, e ka lavdëruar yllin Lamine Yamal, protagonistin absolut në fitoren e Barcelonës ndaj Gironës (1-4). "Jam shumë i lumtur për dy golat e tij. Lamine është shumë i ri, por ai është me të vërtetë i jashtëzakonshëm, për më tepër në një moshë kaq të re. Ai është i rëndësishëm për ne, jo vetëm për klasën që ka, por ndihmon shumë ekipin duke ushtruar presion", ka deklaruar Flick.

Enrique: PSG-ja po shkon në drejtimin e duhur

Trajneri i PSG-së, Luis Enrique, është shprehur i lumtur me fillimin e skuadrës së tij në këtë sezon të garave. Kampionët në fuqi të Francës mundën Brestin (3-1) të shtunën që lamë prapa duke arritur fitoren e katërt në po aq ndeshje të këtij edicioni. Strategu spanjoll është i kënaqur jo vetëm me fitoren, por edhe me paraqitjen e të besuarve të tij ndaj Brestit. "Nuk është vetëm fitorja. Është edhe mënyra se si luajtëm për ta marrë fitoren. Është një provë e mëtejshme se ne po shkojmë në drejtimin e duhur", ka thënë Enrique.

Cannavaro: Dua të rikthehem në stol, por ka shumë konkurrencë

Duke folur në "Radio1", ish-mbrojtësi i Italisë, kampion i botës në futboll, Fabio Cannavaro, bëri një bilanc për të ardhmen e tij. Ai u largua nga Udinese në fund të sezonit të kaluar dhe është ende pa ekip. "Kam shpenzuar shumë kohë duke parë ndeshjet për të qenë sa më i përditësuar, por ideja ime është të kthehem në stol. E di që nuk është e lehtë, pasi ka shumë konkurrencë, por unë punoj për të qenë gati", ka deklaruar Cannavaro. Pas rikthimit nga Kina, trajneri 51-vjeçar italian nuk ka pasur shumë sukses në Itali, ku para se të drejtojë për pak muaj Udinese ka qenë edhe në krye të Beneventos. Duke se ai është në pritje të një projekti serioz për të ardhmen.



Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrja n ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas nenit 8,dhe në bazë të Udhzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024, Kryeshefi Egzekutiv i Kompanis Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë me datë 17.09.2024, shpall konkurs të brendshëm për këto vende të punës :

KONKURS I BRENDSHËM

Pozita : Kontrolleret i brendshem - Inspektor 1 pozitë

Vendi punës : Klinikë
Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.
Koeficienti i pagës 2.2

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Inspekton terenin se a është bere dorezimi i faturave te konsumatorët.
- Inspekton terenin se a është bere perditsim i te dhenave per konsumatorët,siguron qe borxhi i konsumatorve te precizohet,dhe te mos bartet nga nje person tek tjetri pa e rregulluar borxhin e meparshem. .
- Bene inspektimin,monitorimin dhe rishikimin e aktiviteteve te inkasantave.
- Regjistron ne programin e ndermarrjes konsumatorët si,emrin,emrin e prindit,numrin personal te konsumatorit dhe te dhenat per biznes sipas qertifikates se biznesit,keto shenime pranohen nga inkasante,dhe te kontrollohen nga inspektora se a jan plotsuar kushtet per regjistrim.
- Komunikon brenda institucionit dhe jasht tij per sherbime me te mire per konsumatorët.
- Ne baze te konstatimit te gjendjes reale,dhe te gjeturave ne teren,raporton tek mbikqyrsi i tij.
- Punon planet dhe raportet ditore,mujore,dhe vjetore te punes.
- Angazhohet drejtperdrejt me rastin e zgjedhjes se kontesteve te faturimit dhe reklamimeve nga ana e konsumatoreve dhe eshte pergjegjes per dhenjen e shenimeve te duhura per zgjidhjen e ketyre kontesteve.
- Udheheq punen ne lidhjen e kontratave me konsumatore dhe zbulimin e konsumatoreve te rinje privat dhe te biznesit,dhe regjistrimin e tyre ne dosje te konsumatoreve.
- Verifikimi i kryerjes se sherbimit ne teren nga ana e ndermarrjes mbi grumbullimin dhe deponimin e mbeturinave..
- Detyrohet të zbatojë disiplinën në punë, kodin e etikës, rregulloret / rregullat e caktuara nga ndërmarrja për këtë proces pune dhe në rast të shkeljes së tyre mban përgjegjësi disiplinore;
- Kryen edhe punë tjera me urdhëres të KE.
- Për mos respektimin e pikave te lartecekura i përgjigjet drjtëpërdrejtë, Kryeshefit Ekzkativ.

a. Kushtet e përgjithshme :

- CV ;
- Certifikatë që kandidati nuk është nën hetime ;
- Letër motivimi ;
- Kopja e letërnjoftimit ;
- Certifikatë mbi gjendjen shëndetësore ;

b. Kushtet e veçanta: (kualifikimet profesionale)

- Shkolla e Mesme e preferuar Diplomë universitare
- Njohja e punës me kompjuter
- Të ketë përvojë pune
- Aftësia të mir komunikimi

Pozita : Sigurim i Objektivit 1 pozitë

Vendi punës : Klinikë
Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.
Koeficienti i pagës 1.7

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Përcjell hyrje-daljen e palëve, punëtorëve dhe automjeteve
- Daljen e punëtorëve pa leje paraprake, të parakohshme i evidenton në libër të vecant.
- Palët duhet t'i jape fletëhyrjen dhe i orienton për në shërbimet për të cilat janë të interesuara.
- Është i obliguar për sjellje korrekte me pale dhe për qëndrim në vendin e tij të punës
- Bënë sigurimin e objektit në të cilin është përcaktuar në bazë të planit mujor.
- Bënë shiqimin e gjendjes së objektit dhe mjeteve kundër zjarrit dhe rregullis së tyre.
- Vigjilon dhe largon personat e paautorizuar dhe të dyshimt që ndodhen afër objektit
- Ndërmerr masat e nevojshme në mbrojtjen e objektit nga dukurit natyrore dhe për këtë lajmëron menjëherë shërbimet e specializuara
- Pranon dhe dorëzon ndrrimin dhe për gjendjen e objektit e informon punëtorin e sigurimit të radhës
- Obligohet që në vendin e punës të mbajë uniformën.
- Pas orarit të rregullt të punës nuk guxon t'i lejoj hyrjen e personave të paautorizuar, përveç zyrtarëve të lartë të Ndërmarrjes
- Është përgjegjës i përgjithshëm i materialit dhe automjeteve, gjatë kohës së orarit të punës, me rastin e marrjes dhe dorëzimit të detyrës.
- Ndalon personat dhe automjetet e pa autorizuar dhe ndalon hudhjen e mbeturinave nga ana e popullates lokale
- Të kryej punë të cilat i besohen mbrenda ditës, të ketë kujdesë në punë në mënyrë që mos të vjen gjerë te ndezja e mbeturinave.
- Në rast të ndonjë avarie, ta evitoj ate dhe të lajmëroj shefin e sigurimit dhe organet kompetente.
 - Ndihma e shpejtë – 194,
 - Emergjencia Civile – 112,
 - Zjarrfikësi – 193,
 - Policia – 119
- Të punojë të shtunave dhe të dielave.
- Kryen pune bazuar ne kontraten e punes por edhe punë tjera me urdhëres të Shefit të sigurimit.
- Për mos respektimin e pikave te lartecekura i përgjigjet drjtëpërdrejtë, Kryeshefit Ekzkativ.

a.Kushtet e përgjithshme :

- Një CV te detajuar
- Certifikata që kandidati nuk është nën hetime
- Letër motivimi
- Kopja e letërnjoftimit
- Certiflata mbi gjendjen shendetsore

Mënyra e Aplikimit:Dokumentacioni duhet të dërgohet ne e-mailit krmbientikonkurset@gmail.com
Data e për aplikim është nga 17.09.2024 deri me 02.10.2024 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm.. Dokumentet origjinale mund të kërkohen, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.



Kuvendi Komunal, Malishevë
Drejtoria Komunale e Arsimit

Gjimnazi "Hamdi Berisha" -
Malishevë



Nr. prot.: 93/24

Datë:16.09.2024

Mbështetur në Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.02/2016 për aktivitetet jashtë shkollore, Gjimnazi "Hamdi Berisha" në Malishevë shpallë:

OFERTË PËR EKSKURSION

Gjimnazi "Hamdi Berisha" në Malishevë shpallë ftesë për ofertë për zgjedhjen e agjencionit të udhëtimit për organizimin e Shëtities (Eskursionit) në Republikën e Shqipërisë me maturantë për vitin shkolror 2024/2025.

Kohëzgjatja e shëtities (ekskursionit) do të jetë 4 bujtje / 5 ditë, me pension të plotë.

Në ekskursion do të marrin pjesë 300 nxënës.

Agjencioni duhet të plotësojë këto parakushte:

- Agjencioni duhet të jetë i licencuar.
- Të ketë fletëdëshminë e kontrollës teknike të autobusëve sipas procedurave ligjore.
- Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e nxënësve, përparësi kanë autobusët me vitin më të ri të prodhimit.
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusëve.
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe të ketë dëshmitë (certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që i shoqëron nxënësit.
- Agjencioni duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e akreditimit të ushqimeve në Shqipëri të vulosur dhe nënshkruar nga pronari i hotelit.
- Kategorizimi do të bëhet në bazë të kriterëve dhe sigurisë për nxënësit, ku edhe do të vendoset për ofertën dhe vendin e vendosjes së nxënësve (hotelin), nga komisioni përkatës, ditën e hapjes së ofertës.
- Agjencioni duhet të prezantojë menyë ditore për secilën ditë të qëndrimit në Shqipëri të vërtetuar dhe nënshkruar nga pronari i hotelit.
- Kontrata në mes të agjencionit dhe hotelit.
- Një fletëkonfirmim të rezervimit të hotelit përkatës të vërtetuar në mes të kompanisë dhe hotelit me datë të caktuar.
- Licenca e ballos (vallëzimit) e vulosur dhe nënshkruar nga pronari i hotelit, ku nxënësit do të argëtohen.
- Hoteli ku bëhet akomodimi i nxënësve duhet të ketë shërbimin e sigurimit fizik dhe profesional.
- Vërtetimi i ATK-së.
- Agjencioni duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve të deklaruar në ATK, që do të marrin pjesë në shëtitje (ekskursion).
- Agjencioni duhet t'i mbulojë shpenzimet e vizitave të nxënësve në monumentet historike.

Ofertat të cilat nuk i përmbushin kriteret e kërkua nuk do të merren në shqyrtim.

- Afati i aplikimit është shtatë (7) ditë nga dita e shpalljes nga data 17.09.2024 deri më 23.09.2024 (ditën e hën).

- Ofertat pranohen në sportelin e DKA-së në Malishevë.

- Hapja e ofertave do të bëhet më 23.09.2024 (ditë e hën) ditën e fundit të aplikimit duke filluar nga ora 14:00, në shkollë.

Malishevë

17.09.2024

Gjimnazi "Hamdi Berisha" - Malishevë

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

